



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Bulevardi "Zog I", Godina 57/2 Nr.18 Tiranë,

Tel. 04 268142; Fax 04 268141

Nr. 337/ Prot.
6

Tiranë, më 14.09. 2015

V E N D I M

Nr. 95, datë 14/09/2015

“Për miratimin e raportit përfundimtar të inspektimit të përgjithshëm, në lidhje me procesin e administrimit të shërbimit civil në Këshillin e Qarkut Durrës”

Në mbështetje të kompetencave të parashikuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15 të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, neneve 14 germa “b”, 32 e 33 të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil (më poshtë rregullores), si dhe neneve 80-104 të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, pas shqyrtimit të materialit të përgatitur dhe mendimit të Drejtorisë së Inspektimit dhe Hetimit Administrativ, në lidhje me inspektimin e zhvilluar në Këshillin e Qarkut Durrës,

Vërej se:

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil ka rënë në dijeni të faktit se Këshilli i Qarkut Durrës, me Vendimin nr. 2, datë 30.01.2015, “Për miratimin e strukturës organizative të Këshillit të Qarkut Durrës”, kishte kryer procesin e ristrukturimit të institucionit. Si rrjedhojë e zbatimit të ligjit nr. 160/2014, “Për buxhetin e vitit 2015”, pati një kufizim të ndjeshëm të fondeve të institucionit e natyrshëm, kjo diktonte reduktimin e numrit të punonjësve të Këshillit të Qarkut Durrës, duke vendosur lirimin e disa prej tyre nga shërbimi civil.

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në mbështetje të nenit 11, pika 1, si dhe të nenit 14, pikat 1 e 2 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, duke vlerësuar nevojën për verifikim të këtij informacioni, me aktin administrativ nr. 34, datë 24.04.2015, “Për kryerjen e inspektimit në lidhje me zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil, si dhe në lidhje me procesin e ristrukturimit të institucionit, Këshilli i Qarkut Durrës”, ka vendosur kryerjen e inspektimit të përgjithshëm, duke përfshirë në objektin e inspektimit procesin e ristrukturimit, si dhe

duke e shtrirë më tej inspektimin, në të gjitha institutet e tjera të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Inspektimi u zhvillua në përputhje me vendimin nr. 41, datë 24.04.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, i cili në bazë të nenit 21 të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, i është njoftuar institucionit me shkresën nr. 337 prot., datë 24.04.2015, “Njoftim për fillimin e inspektimit”. Në përfundim të procesit të inspektimit të përgjithshëm, në përmbajtje të të cilit u trajtuan gjithë aspektet e administrimit të shërbimit civil, sipas parashikimit në planin e inspektimit, grupi i mbikëqyrjes ka hartuar projektraportin, i cili i është dërguar për njohje subjektit të kontrolluar, me shkresën nr. 337/3, datë 30.07.2015, “Dërgohet projektraporti i inspektimit në institucionin e Këshillit të Qarkut Durrës, në lidhje me zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil”, duke i lënë 5 ditë kohë për të paraqitur observacionet në lidhje me materialin. Pas kësaj, projektraporti është kthyer i nënshkruar nga titullari i institucionit dhe drejtori përkatës, me shkresën nr. 921/4 prot., datë 10.08.2015, “Kthim përgjigje”, regjistruar pranë Komisionerit me nr. 337/4 prot., datë 20.08.2015.

Nga përmbajtja e shkresës përcjellëse rezulton se subjekti i inspektuar është shprehur dakord me rekomandimet e nxjerra nga grupi i punës dhe nuk ka bërë asnjë vërejtje në lidhje me materialin.

Sa më sipër, çmoj se janë kryer të gjitha procedurat e nevojshme që sigurojnë transparencën e procesit dhe mundësinë e institucionit të kontrolluar për të shprehur pretendimet e tij në lidhje me problematikën e evidentuar. Në këto rrethana, pas shqyrtimit të përmbajtjes së raportit përfundimtar të inspektimit, të paraqitur për miratim nga grupi i punës vlerësoj se duhet të miratoj përmbajtjen e tij.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2013, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

V E N D O S A:

1. Të miratoj raportin përfundimtar të inspektimit në lidhje me procesin e administrimit të shërbimit civil në institucionin Këshilli i Qarkut Durrës, i cili do të jetë pjesë e këtij vendimi.
2. Të kryhet procesi i deklarimit të statusit të punësimit për punonjëset ***** dhe ***** dhe më tej të nxirren aktet përkatëse për sistemimin pas ristrukturimit.
3. Njësia përgjegjëse, në zbatim të nenit 115 të Kodit të Procedurave Administrative, duhet të bëjë revokimin e akteve të emërimit për punonjësit si më poshtë:
 - a. Të revokohet akti i emërimit nr.1738 prot., datë 03. 12.2014, për punonjësen ***** , në pozicionin “Specialist i koordinimit dhe hartimit të projekteve në Sektorin e Hartimit, Koordinimit, Zbatimit të Projekteve dhe Politikave Sociale”, si dhe të vijohet me

nisjen e procedurës së konkurimit sipas përcaktimeve të Kreut IV “Pranimi në shërbimin civil”, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, për plotësimin e këtij pozicioni që lirohet.

- b. Të revokohet akti i emërimit nr.1743 prot., datë 05.12.2014, për punonjësën ***** , në pozicionin *Specialist i Zbatimit të Projekteve në Sektorin e Hartimit, Koordinimit, Zbatimit të Projekteve dhe Politikave Sociale*, si dhe të vijohet me nisjen e procedurës së konkurimit sipas përcaktimeve të Kreut IV “Pranimi në shërbimin civil”, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, për plotësimin e këtij pozicioni që lirohet.
 - c. Të revokohet akti i emërimit nr. 1740, datë 03.12.2014, për punonjësën ***** , në pozicionin *Specialiste e Zhvillimit të Mjedisit në Sektorin e Mbrojtjes dhe Zhvillimit të Mjedisit*, si dhe të vijohet me nisjen e procedurës së konkurimit sipas përcaktimeve të Kreut IV “Pranimi në shërbimin civil”, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, për plotësimin e këtij pozicioni që lirohet.
 - d. Të revokohet akti i emërimit nr. 1703, datë 27.11.2014, për punonjësën ***** , në pozicionin *Specialist Kulture në Sektorin e Turizmit dhe Kulturës në Drejtorinë e Zhvillimit Urban dhe Turizmit*, si dhe të vijohet me nisjen e procedurës së konkurimit sipas përcaktimeve të Kreut IV “Pranimi në shërbimin civil”, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, për plotësimin e këtij pozicioni që lirohet.
4. Njësia përgjegjëse të bëjë regjistrimin e këtyre nëpunësve në listën e kandidatëve fitues, e cila është e vlefshme për një periudhë 2-vjeçare, duke përfutur nga mundësia që jep ligji për emërim të drejtpërdrejtë prej saj, sapo të konstatohet një pozicion i lirë, ku kandidati plotëson kërkesat e veçanta të atij pozicioni.
 5. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative lihet afat **30** ditë nga marrja dijeni për këtë vendim. Njësia përgjegjëse duhet të zbatojë këtë vendim duke u bazuar në rekomandimet e dhëna në përmbajtjen e raportit.
 6. Për këtë vendim të njoftohet Këshilli i Qarkut Durrës, duke i dërguar një kopje të raportit përfundimtar të inspektimit dhe, njëkohësisht, të informohet Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut në Kuvendin e Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA